

PwC Albania Tax and Legal Alert

February 2021





PwC Albania - Tax and Legal Alert

February 2021

Shkurt 2021

In this summary you will find the latest tax and legal changes which have been approved as well as the draft laws that are under discussion.

Në këtë përmbledhje do të gjeni ndryshimet e fundit tatimore dhe ligjore të cilat janë miratuar si dhe projektligjet që janë në diskutime.

On social insurance

Families that have accidentally lost their members as a result of actions performed during the exercise of duty by law enforcement officers, are entitled to benefit special financial treatment up to 8 times of the social pension.

[Source: Normative Act no. 33, dated 11.12.2020 for an addition to law no. 7703, dated 11.5.1993, "On social insurance in the Republic of Albania", as amended]

Për sigurimet shoqërore

Përfiton trajtim të vecantë financiar deri në 8-fishin e pensionit social, familja që ka humbur aksidenatlisht pjesëtarë të saj, si pasojë e veprimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjës të organeve ligjzbatuese.

[Burimi: Akti Normativ nr. 33, datë 11.12.2020 për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar]

On minimum wage

Starting from January 2021, the minimum monthly salary in Albania is 30,000 ALL. This salary corresponds to 174 normal working hours per month, where the minimum hourly wage is set to 172.4 ALL. Similarly, the maximum monthly salary for the purposes of calculating social security contributions is increased in line with the minimum monthly salary. Consequently, the amount of the maximum monthly salary for purposes of calculating social contributions has become 132,312 ALL.

[Source: Decision no. 1025 dated 16.12.2020, "On determining the minimum wage nationwide"]

Për përcaktimin e pagës minimale

Duke filluar nga muaji janar 2021, paga bazë minimale mujore në shkallë vendi, e detyrueshme për zbatim është 30,000 (tridhjetë mijë) lekë. Kjo pagë korrespondon për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës, ku paga bazë minimale orare është 172.4 (njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë katër) lekë. Në të njëjtën kohë, paga maksimale për efekt sigurimesh është rritur duke u indeksuar me të njëjtë normë sa paga minimale në shkallë vendi. Rrjedhimisht, paga maksimale për efekt kontributesh është 132,312 lekë.

[Burimi: Vendimi nr. 1025 datë 16.12.2020, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"]

On the registration of beneficial owners

The decision that explains in detail the procedures determining the establishment of the Beneficial Owners Registry and the applications regarding the registration of the beneficial owners' data, which are prone to start by 31 January 2021, along with the necessary documents that reporting entities must keep and preserve as per the provisions of the law "On the Register of Beneficial Owners", is approved. As envisaged by law:

- The authorized person can access electronically the e-albania portal by filling in the application form and attaching the required documents listed in the decision.
- The application and the supporting documents are reviewed by the personnel of NBC, based on the order received.
- If there are discrepancies in the data published in the Register of Beneficial Owners with the data that the reporting entity has submitted at the NBC, a notification must be sent in writing within 10 calendar days from the date of ascertainment.

Për regjistrimin e pronarëve përfitues

Eshtë miratuar vendimi që shpjegon në mënyrë më të detajuar procedurën e regjistrimit të pronarëve përfitues në regjistrin që pritet të krijohet brenda datës 31 Janar 2021 si edhe dokumentat e nevojshme që subjektet raportuese duhet të mbajnë dhe të ruajnë për pronarët përfitues sipas kërkesave të ligjit "Mbi Regjistrin e Pronarëve Përfitues". Sipas këtij vendimi:

- Personi i autorizuar kryen procedurën elektronikisht në portalin e-albania duke plotësuar përkatësisht formularin e aplikimit dhe duke bashkangjitur dokumentat shoqëruese të listuara në vendim;
- Aplikimi dhe dokumentet shoqëruese në format elektronik merren në shqyrtim nga nëpunësit e autorizuar të QKB-së për vendimarrje, sipas radhës së paraqitjes së tyre;
- Në rastet kur subjekti i detyruar, konstaton një mospërputhje të të dhënave të publikuara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues me të dhënat që ai zotëron lidhur me pronarët përfitues, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e konstatimit, subjekti duhet të njoftojë me shkrim subjektin raportues dhe QKB-në.

For initial registrations of beneficial owners, the following documents should be submitted during the application process:

- Documentation certifying the identification data of the beneficial owner.
- Documentation proving that the registered beneficial owner holds 25% or more of the shares / equity / voting rights or interests, as well as the appointment date as beneficial owner.
- Any other documentation containing relevant information for the identification and registration of the beneficial owner.

Në rastin e regjistrimeve fillestare të pronarëve përfitues, personi i autorizuar gjatë aplikimit bashkangjitur dokumentat e mëposhtëm:

- Dokumentacion që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues;
- Dokumentacionin që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotëruar i 25 % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit/të të drejtave të votimit ose interesave të pronësisë dhe datën e përcaktimit si pronar përfitues; ose
- Dokumentacionin tjetër që zotëron subjekti raportues, që përmban informacionin e nevojshëm për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues të tij.

[Source: Decision of the Council of Ministers no. 1088, dated 24.12.2020, "On determining the manner and procedures of registration and publication of data for beneficial owners, as well as notification by the competent state authorities and by the obligated subjects"]

[Burimi: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1088, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara"]



On the use of simplified "fiscalization" procedures

- Taxpayers who carry out non-cash transactions with public institutions can issue and fiscalize electronic invoices for these transactions through the central invoicing platform until 30 June 2021.
- Taxpayers who issue invoices for cash transactions are required to simultaneously meet the criteria set out in the Decision in order to issue invoices and perform fiscalization procedures through the use of the central invoicing platform. In addition to the existing criteria, taxpayers shall meet the following additional criteria:
 - Are subject to simplified corporate income tax for small businesses;
 - Have only one place of business activity.

[Source: Decision of the Council of Ministers no.1091, dated 24.12.2020, "On some additions and changes to the decision no.220, dated 12.3.2020, of the Council of Ministers, "On determining the category of taxpayers and the criteria for using the simplified procedure of fiscalization "]

On the Central Register of Bank Accounts

This law has been adopted in the framework of the fight against corruption and money laundering, and includes in its objective all financial institutions that operate in the Republic of Albania and provide financial services such as banking accounts or safe deposit box to assist their clients.

The Central Register of Bank Accounts has the following characteristics:

- Central Register of Bank Accounts and Safe Deposit Box, will serve as a state database, in which the data are registered and stored electronically;
- The data registered and stored is not available to the public;
- The General Tax Directorate is the institution that manages and administers the register.

Financial institutions have the following obligations:

- Establish and administer systems that provide real-time data reporting, after completion of operations with bank account or safe deposit box holders, and report this data electronically, using the central automated system as per the reporting file format;
- To identify, create and maintain relevant documents for bank account holders within 3 months from the entry into force of this law;
- To transmit the required data of the bank accounts and safe deposit box holders no later than 60 calendar days from the establishment of the register;
- Ensure that in the first reporting, information on bank accounts or safe deposit box that have been closed in the last 5 years, before 1.1.2020, will be disclosed by all financial institutions based on the information readily obtainable;
- To preserve all the data included in the register and other legal documentation for 10 years from the closing of the bank account or the safe deposit box by the end of the personal data protection term.

Financial institutions have the following responsibilities:

- Are responsible for the accuracy and completeness of the data reported under this law and shall take all necessary measures for this purpose;
- If detected that any of the data reported for the purpose of this law is inaccurate or incomplete, financial institutions shall immediately notify within 72 hours the unit responsible within the General Directorate of Taxes in order to take the necessary measures for correcting the inaccurate information.
- They are not responsible for the non-fulfillment of the obligations defined in this law and the bylaws in its implementation, which come as a result of the state of emergency, wars, other civil unrest and natural disasters.

Për përdorimin e procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit

- Tatimpaguesit që kryejnë transaksione pa para në dorë me organet publike mund të lëshojnë dhe fiskalizojnë fatura elektronike për këto transaksione nëpërmjet platformës qendrore të faturave, deri në datën 30 qershor 2021;
- Tatimpaguesit që lëshojnë fatura për transaksione me para në dorë u kërkohet të përmbushin njëkohësisht kriteret e përcaktuara në VKM me qëllim lëshimin e faturave dhe kryerjen e procedurave të fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave, dhe përveç kriteve ekzistuese, tatimpaguesit përmbushin edhe kriteret si më poshtë:
 - Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
 - Nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

[Burimi: Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1091, datë 24.12.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.220, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kriteve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit"]

Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare

Ky ligj është miratuar në kuadër të të luftës ndaj korrupsionit dhe pastrimit të parave dhe ka si objekt të tij të gjitha institucionet financiare, të cilat veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe ofrojnë shërbimet e llogarive bankare ose të kasetave të sigurisë për klientët e tyre.

Regjistri Qendror i Llogarive Bankare ka karakteristikat si më poshtë:

- Regjistri Qendror i Llogarive Bankare dhe i kasetave të sigurisë, do të shërbejë si një bazë e të dhënave shtetërore, në të cilin regjistrohen e ruhen të dhënat, sipas përcaktimeve të ligjit, në formë elektronike;
- Informacioni i ruajtur në regjister nuk është i disponueshëm për publikun;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është institucioni administrues i regjistrit.

Institucionet financiare kanë detyrimet si më poshtë:

- Të krijojnë dhe të administrojnë sisteme që sigurojnë raportimin e të dhënave në kohë reale, pas përfundimit të veprimeve me mbajtësit e llogarisë bankare ose të kasetave të sigurisë, si dhe të raportojnë të dhënat në regjister në mënyrë elektronike, duke përdorur mekanizmin qendror të automatizuar sipas formatit të skedarit të raportimit;
- Të identifikojnë, të krijojnë e të mbajnë dokumentet përkatëse për mbajtësit e llogarive bankare brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- Të transmetojnë të dhënat e kërkuara nga ky ligj për mbajtësit e llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë jo më vonë se 60 ditë kalendrike nga krijimi i regjistrit;
- Të sigurojnë që në raportimin e tyre të parë të përfshijnë edhe të dhënat për llogaritë bankare ose kasetat e sigurisë të mbyllura 5 vitet e fundit, ku përjashtimisht, për llogaritë e mbyllura përpara datës 1.1.2020, institucionet financiare të raportojnë ato të dhëna që disponojnë;
- Të ruajnë të plotat të gjitha të dhënat e administruara nga regjistri dhe dokumentacioni tjetër ligjor për 10 vjet nga mbyllja e llogarisë bankare ose e kasetës së sigurisë dhe në përfundim të afatit të ruajtjes së të dhënave personale, t'i fshijnë këto të dhëna nga regjistri.

Institucionet financiare kanë përgjegjësitë si më poshtë:

- Janë përgjegjëse për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të raportuara në bazë të këtij ligji dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim;
- Nëse zbulojnë se ndonjë prej të dhënave të raportuara për qëllim të këtij ligji është e pasaktë ose e paplotë, njoftojnë menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë, njësinë përgjegjëse për regjistrin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duke marrë masa njëkohësisht për korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota dhe duke i raportuar ato sërish.
- Nuk mbajnë përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, që vijnë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, të luftërave, të trazirave të tjera civile dhe fatkeqësive natyrore.



When they do not constitute a criminal offense, violations of the provisions of this law constitute administrative contraventions and are punishable by a fine.

[Source: Law no. 154/2020, "On the Central Register of Bank Accounts"]

Law on Fiscal Regime for the Hydrocarbon Sector

The draft law on the Fiscal Regime for the Hydrocarbon Sector has been approved, and is now into force. The new law provides the fiscal regime applicable to hydrocarbon operations and aims to:

- a) regulate the royalty tax and the profit tax for hydrocarbon operations, as well as their administration.
- b) regulate the extent to which a hydrocarbon agreement may affect the obligation to pay taxes and duties, as well as the applicable local and national taxes/levies.

The new law defines the taxable income, deductible expenses and non-deductible expenses for the purpose of calculating the taxable profit from hydrocarbon operations, and differentiates between hydrocarbon operations and non-hydrocarbon operations. It also determines royalty tax obligations, and considers related party transactions, local taxes, and transfer of hydrocarbon rights, among others.

Subject to this law are the following persons:

1. Legal entities that perform hydrocarbon operations on land (onshore);
2. Persons performing authorized hydrocarbon operations;
3. The above legal entities that perform directly or indirectly hydrocarbon operations (referred to as "subcontractors"), and meet one of the following criteria:
 - a. The subcontractor performing hydrocarbon operations is considered a "related party" to the contractor in accordance with the Income Tax Law.
 - b. The subcontractor is an operator of hydrocarbon operations and performs activities which are essential for hydrocarbon operations, and as such, invoices at least 25% of the total expenses of the hydrocarbon operations of the authorized person.
 - c. The main purpose of the agreement concluded with the subcontractor is to avoid
 - d. the application of the tax regime under this law and to benefit from the preferential tax rate under the Income Tax Law.

For further details on the changes and other information on the law, please click the [link](#)

[Source: Law no. 153/2020, "On the Fiscal Regime for the Hydrocarbon Sector".]

The Council of Ministers is looking into the following draft laws:

Draft law on some changes and additions to law no. 108/2013 "For Foreigners"

This draft law is expected to bring the following changes:

- In addition to the existing purposes listed in the law on foreigners, foreigners can apply for a type D visa also for residence purposes for retired foreign nationals D / P;
- The foreigner is provided with a residence permit for foreign citizens in retirement when he meets the conditions and it is assessed that the submitted documentation meets the requirements for obtaining such a permit;
- After the issuance of this permit, its holder has the obligation to notify the responsible authorities of any change in his income;
- The responsible authority revokes the residence permit in the cases provided by law.

Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

[Burimi: Ligj nr. 154/2020, "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare"]

Ligji për Regjimin Fiskal në Sistemin Hidrokarbur

Projektligji për Regjimin Fiskal në Sistemin Hidrokarbur është miratur, dhe ka hyrë në fuqi tashmë. Ligji në fjalë parashikon regjimin fiskal të zbatueshëm për operacionet hidrokarbure dhe synon:

- a) rregullimin e detyrimit për taksën mbi rentën minerare, tatimin mbi fitimin për operacionet hidrokarbure, si dhe administrimin e tyre;
- b) rregullimin e masës në të cilën një marrëveshje hidrokarbure mund të ndikojë në detyrimin për vendosjen e taksave e të tatimeve, si dhe taksat/tatimet vendore dhe kombëtare të aplikueshme.

Ligji i ri përcakton të ardhurat e tatueshme, shpenzimet e njohura dhe të panjohura për qëllime të përcaktimit të fitimit të tatueshëm nga operacionet hidrokarbure, dhe dallon operacionet hidrokarbure dhe jo-hidrokarbure nga njëra tjetra. Gjithashtu, përcakton detyrimet e rentës minerare, dhe konsideron transaksionet me palët e lidhura, taksat lokale, dhe të drejtat e transferimit të operacioneve hidrokarbure ndër të tjera.

Objekt i këtij ligji janë personat e mëposhtëm:

1. Personat juridikë që kryejnë operacione hidrokarbure në tokë (onshore);
2. Personat që kryejnë operacione hidrokarbure të autorizuara;
3. Personat juridikë më lart dhe që kryejnë direkt ose indirekt operacione hidrokarbure (të referuar si "nënkontraktorë"), dhe plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:
 - a. nënkontraktori që kryen operacione hidrokarbure konsiderohet "palë i lidhur" me kontraktorin sipas përkufizimit të "palëve të lidhura" sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat;
 - b. nënkontraktori është operator në lidhje me operacionet hidrokarbure dhe kryen aktivitete të cilat janë thelbësore për operacionet hidrokarbure, ku niveli i aktiviteteve të faturuara nga nënkontraktori, është jo më pak se 25% e totalit të shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të personit të autorizuar;
 - c. qëllimi kryesor i marrëveshjes me nënkontraktorin është shmangia nga nënkontraktori i normës së tatimit sipas këtij ligji dhe përfitimi i normës tatimore sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Për më shumë detaje në lidhje me ndryshimet dhe informacionet e tjera mbi ligjin, ju lutem klikoni në [link](#)

[Burimi: Ligj nr. 153/2020, "Për Regjimin Fiskal në Sektorin Hidrokarbur"]

Projektligji në shqyrtim nga Këshilli i Ministrave

Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013 "Për të Huajt"

Ky projektligj pritet të sjellë ndryshimet e mëposhtme:

- Përveç qëllimeve ekzistuese të listuara në ligjin për të huajt, të huajt mund të aplikojnë për vizë të tipit D edhe për qëllime qëndrimi për qytetarë të huaj në pension D/P;
- I huaji pajiset me leje qëndrimi për qytetarë të huaj në pension, kur përmbush kushtet dhe vlersëohet se dokumentacioni i paraqitur plotëson kërkesat për marrjen e një leje të tillë;
- Pas lëshimit të kësaj leje, mbajtësi i saj ka detyrimin të njoftojë autoritetet përgjegjëse për çdo ndryshim në të ardhurat e tij;
- Autoriteti përgjegjës revokon lejen e qëndrimit në rastet e parashikuara nga ligji.



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

